



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.02.2019, ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 5, 6 dhe 11 shkurt 2019.
2. Projektvendimi “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.
3. Projektvendimi “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Fatmir Xhafaj, Spartak Braho, Oerd Bylykbashi, Astrit Veliaj, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar :

Vilma Causholli – Përgjegjëse Sektori në Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave

Enkela Dudushi - Drejtoreshë e Sektorit të Organizimit, Funkcionimit dhe Zhvillimit të Pagave pranë DAP-it

Naureda Llagami – Kryetare e KLGJ-së

Gent Ibrahimimi – Kryetar i KLP-së

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i pranueshëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës. Si fillim kemi miratimin e procesverbaleve të datave 5 shkurt, 6 shkurt dhe 11 shkurt të vitit 2019. Ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka!

Komisioni miraton procesverbalet e datave 5 shkurt, 6 shkurt dhe 11 shkurt të vitit 2019.

Kalojmë te pika e dytë dhe e tretë e rendit të ditës, të cilat janë të njëjta dhe do të shqyrtohen bashkërisht, projektvendimi “Për miratimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe projektvendimi “Për miratimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Komisioni i Ligjeve është komision përgjegjës. Relator për të dyja projektvendimet do të jetë kolegu Bashkim Fino.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: nga Ministria e Financave zonja Vilma Causholli, përgjegjëse Sektori në Departamentin e Buxhetit, zonja Enkela Dudushi, drejtoreshë e Sektorit të Organizimit, Funkcionimit dhe Zhvillimit të Pagave pranë DAP-it, zonja Naureda Llagami, kryetare e KLGJ-së së bashku me nënkryetarin e KLGJ-së, zotin Maksim Qoku, dhe zoti Gent Ibrahim, kryetar i KLP-së.

Zonja Llagami, zoti Ibrahim, zoti Qoku, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Pa humbur kohë, do t’ia kaloj fjalën zonjës Llagami për të bërë prezantimin e strukturës që ka miratuar Këshilli i Lartë Gjyqësor, të cilën ia ka propozuar Kuvendit të Shqipërisë për miratim. Më pas, do t’ia kaloj fjalën kolegut Bashkim Fino.

Naureda Llagami – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Jam këtu si përfaqësuese e KLGJ-së, për të cilin ju, si përfaqësues ligjvënës, e keni shprehur vullnetin tuaj të plotë për krijimin e këtij institucioni si të pavarur, me targete të qarta të shprehura në Kushtetutë dhe në të gjitha ligjet, pjesë e paketës së reformës.

Me vetëdijen se jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kemi, do të doja që ky diskutim që do të zhvillojmë sot, të mos jetë thjesht një diskutim për strukturën, njësitë dhe numrat. Ju siguroj që kemi treguar maturinë e nevojshme dhe i kemi konsideruar me vëmendje si sugjerimet e kolegëve, ashtu edhe të partnerëve ndërkombëtarë. Për këtë arsye, do të kërkoja nga

ju besimin kundrejt përvojës dhe eksperiencës së kolegëve, anëtarë të KLGJ-së, të cilët e njohin mirë sistemin, problematikën e deritanishme, por edhe nevojat. Do të kërkoja, përveç respektit ndaj pavarësisë së institucionit dhe sistemit të drejtësisë, edhe ndërgjegjësimin e përbashkët për t'u përballur me sfidat e vendosjes në eficientë të sistemit gjyqësor, luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së besimit të publikut. Të gjitha këto kërkojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.

Mbështetja që kërkojmë sot është shprehja jo vetëm e kompetencave të reja që i jep ligji KLGJ-së, numri i akteve që duhet të krijojë ky institucion në zbatim të ligjeve të reformës në drejtësi, konsolidimit jo vetëm të institucionit, por edhe institucioneve të tjera, për të cilat KLGJ-ja ka përgjegjësi funksionale duke filluar nga gjykatat e Shkallës së Parë, të Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nga nëpunësit gjyqësor e deri te gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, pa lënë pa përmendur edhe nevojat për formimin fillestar dhe të vazhduar të gjyqtarëve të rinj dhe kandidatëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Nuk jam e mendimit që Këshilli të fillojë funksionimin me burime minimale njerëzore dhe materiale dhe t'i rrisë këto me kalimin e kohës. Këto vlerësime do të ishin të vlefshme nëse gjithçka do të kishte shkuar sipas parashikimeve dhe afateve ligjore.

Sot sfidat dhe pritshmëritë janë shumëfishuar. Na duhen kapacitete të mjaftueshme, të gjithë së bashku duhet të marrim mbi supë barrën e përgjegjësisë së kaluar e ta kthejmë këtë rrugë të nisur me shumë vështirësi në një sukses.

Para se t'ju përgjigjem pyetjeve tuaja, ju siguroj se për propozimin e prezantuar sot, kemi marrë edhe mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më konkretisht, ju jeni në dijeni për materialet, Këshilli ka miratuar një numër total prej 144 punonjësish. Kur Këshilli ka paramenduar vlerësimin e këtij numri, ka pasur parasysh detyrimet ligjore për shkak të strukturës që i ka vendosur ligji "Për organizimin e institucioneve të drejtësisë", si edhe kompetencat që ka Këshilli në kuadër të ligjeve të reja të miratuara të reformës. Ne jemi munduar që volumi i punës dhe i kompetencave që ka Këshilli me kuadrin ligjor, të gjej zbatim në të gjitha drejtoritë përkatëse që ne kemi propozuar, edhe numrin konform kësaj strukture.

Nëse keni ndonjë pyetje konkrete lidhur me këtë pjesë, jam e hapur të diskutojmë për çdo çështje.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Llagami!

Zoti Fino, pasi kreu i Lartë i Prokurorisë të bëjë prezantimin, mund të bësh një relativim për të dy projektvendimet.

Zoti Ibrahim, fjala për ju.

Gent Ibrahim – Faleminderit, zoti kryetar!

Vij sot këtu në emër të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të prezantuar para jush propozimin e Këshillit për strukturën e tij, për numrin e punonjësve, si dhe propozimin për buxhetin.

Natyrisht, si në rastin e KLGJ-së, edhe në rastin tonë, struktura e propozuar dhe numri i personelit me të cilin propozojmë ta mbushim këtë strukturë, është konceptuar dhe ndërtuar përreth funksioneve kushtetuese të Këshillit. Janë funksione, të cilat më tutje zërthehen në një seri kompetencash me natyrë rregullatore, individuale, që kanë të bëjnë me statusin individual të prokurorëve dhe pjesërisht kompetencë administrative, që ka të bëjë me mbështetjen e punës së Këshillit.

Po kështu, dua të theksoj se ky propozim mban parasysh edhe karakteristikat organizative të këshillit. Si në rastin e KLGJ-së, edhe ne jemi një organ kolegjal i përbërë nga 11 anëtarë, një organ, i cili nënstrukturohet në komitete, të cilat u përgjigjen funksioneve themelore të këshillit: një komitet për vlerësimin e performancës së prokurorëve, një komitet për organizimin e karrierës së tyre, një komitet disiplinor dhe, së fundi, një komitet për çështjet e planifikimit strategjik dhe të buxhetit. Përreth këtyre nëndarjeve strukturore është organizuar edhe propozimi në lidhje me strukturën dhe personelin.

Pa dyshim, ka një problem mentaliteti në këtë pikë, shpesh institucionet e reja që krijohen kanë një qasje minimaliste të propozimet e tyre duke qenë të vetëdijshëm për kufizimet financiare dhe buxhetore, por ndoshta është koha për të bërë një “hop” në këtë pikë, ndoshta nuk është vendi për të filluar gjithmonë me këtë qasje minimale dhe pastaj për të pasur inkrementimin vit pas viti, sepse nevojat tona janë tani.

Siç e dini, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është në procesin e kryerjes së dy detyrave më të rëndësishme, që i kryem tani, në këto muaj, para se të alokohej buxheti dhe struktura. Ne jemi të detyruar nga ligji që ende pa u financuar dhe pa u mbështetur administrativisht dhe financiarisht t’i japim produkt Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorit të Përgjithshëm.

Pra, janë detyra shumë të rëndësishme themelore që konsumohen tani. Atë qasjen, ku në një mënyrë paksa të përkorë institucionet që kanë më pak se sa duhej të kishin vërtet nevojë, me mendimin që pastaj në mënyrë implementale mund të plotësohen nevojat gjatë rrugës, ndoshta nuk

është vendi për ta aplikuar këtë herë, sepse detyrat dhe nevojat janë tani dhe ne duhet t'u përgjigjemi këtyre nevojave me mbështetjen e nevojshme.

Nuk do të zgjatem më shumë, sepse argumentet që përmendi kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë plotësisht të vlefshme edhe për ne, thjesht po e kaloj planin te ju për të reaguar ndaj propozimeve tona.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Zoti Fino, si relator i të dyja projektvendimeve fjala, për ju.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj edhe drejtuesit e KLGJ-së dhe të KLP-së që janë të pranishëm sot këtu, megjithëse ne kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm me ta, do të thosha shterues.

Është e vërtetë që dy shkresat, e zonjës Tagani e datës 24 janar, ka sjellë këtu pranë këtij komisioni miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe e zotit Ibrahim, e datës 25 janar, ka sjellë strukturën e KLP-së. Ato janë konsultuar në mënyrë të gjerë gjatë gjithë kësaj kohe, edhe për shkak të kohës që ka kaluar kemi pasur punë intensive me Ministrinë e Financave, Departamentin e Administratës Publike, kemi marrë mendimin e Ministrisë së Drejtësisë apo të Euralius-it, të cilët na kanë asistuar dhe na kanë dhënë sugjerimet përkatëse.

Më lejoni, anëtarë të komisionit, t'ju them se neni 79, pika 2 dhe neni 178, pika 2 parashikojnë shprehimisht se janë KLGJ-të dhe KLP-të që vendosin për strukturën e administratës në secilën njësi, kjo për arsye se organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë pjesë e një pushteti të pavarur, që do të thotë se gëzojnë pavarësi funksionale, organizative dhe financiare. Komisioni ynë sot shqyrton kërkesat e dy këshillave për arsye se ligji “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019” si rast përjashtimor ka parashikuar (pra e kemi miratuar ne në fund të vitit) miratimin më vete të mbështetjes buxhetore për organet e reja të administrimit të sistemit të drejtësisë, ku këtu hyjnë KLGJ-ja dhe KLP-ja që priten të ngrihen në 2019-ën, por edhe për institucionet e tjera që do ngrihen gjatë 2019-ës do t'ju flas më poshtë.

Komisioni për të analizuar nevojat institucionale me staf arsyetoi mbi kompetencat që ushtrojnë këto organe në sistemin e drejtësisë, të cilat janë të ngjashme, por ndahen vetëm në funksione të trupave të mbikëqyrur për të cilët marrin vendime dhe shifrat duke i krahasuar ato me numrin e trupave të drejtësisë që duhet të mbikëqyrë e të rregullojë edhe organet e reja të drejtësisë.

Komisioni konstaton, pra ne, se në KLGJ, neni 70 i ligjit nr. 115/2016 vë disa piketa, siç u shprehën këtu edhe drejtuesit e KLGJ-së dhe të KLP-së, për organizimin dhe administrimin e KLGJ-së, duke parashikuar që brenda strukturës organizative duhet të ketë patjetër: njësi mbështetëse për çështjet juridike, njësi mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm të këshillit, njësi mbështetëse për hartimin e buxhetit të këshillit dhe buxhetin gjyqësor, zyra e këshilltarit të etikës, njësi mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet, njësi mbështetëse për trajnimin e gjyqtarëve dhe njësi mbështetëse për IT-në.

Pra, sa i takon analizës së nevojshme për mbështetjen buxhetore, duke iu referuar ligjit të buxhetit vjetor në buxhetin e miratuar të vitit 2019, rezulton se fondi total i rezervuar për këto institucione (pra ne ishim të përgatitur për këtë gjë) është rreth 400 milionë lekë. Pra, ky 400-milionësh, këtë duhet ta dinë jo vetëm drejtuesit, por edhe publiku, edhe ju, nuk ka të bëjë vetëm me këto dy institucione, por ka të bëjë edhe me institucionet e tjera që do të krijohen më pas. Sa i takon kompetencës së Kuvendit për miratimin e numrit të punonjësve për 2019-ën, komisioni referon si më poshtë.

Ju e dini se një nga nenet e buxhetit që ne kemi kaluar vitin e kaluar është numri i punonjësve në Republikën e Shqipërisë dhe në këtë numër punonjësish ne sot kalojmë apo miratojmë propozimet që kanë bërë dy institucionet. Nga kjo pikëpamje i takon Kuvendit të miratojë numrin e punonjësve dhe më pas, pas miratimit të numrit të punonjësve, pavarësisht se paraprakisht të dyja institucionet kanë paraqitur nga një strukturë tip, siç e thanë edhe vetë njëri me 144 dhe tjetri me 75 si numër, ne do të miratojmë numrin dhe mbi bazën e këtij numri më pas këto institucione kanë të drejtë për ta riparë edhe një herë strukturën e tyre dhe për të rakorduar pastaj me Departamentin e Administratës Publike, sepse i takon atij të vendosë për kategorizimin e pagave të punonjësve mbi bazën e së cilës bëhet përlllogaritja e 400-milionëshit, se sa do të ketë KLGJ-ja dhe sa do të ketë KLP-ja.

Në rastin e ligjit “Për buxhetin e vitit 2019” është parashikuar, sipas nenit 11, të cilin po jua lexoj që ta dini: “Rishpërndarja e numrit të punonjësve të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe numri rezervë i tyre bëhet nga Këshilli i Ministrave pas miratimit paraprak që do të bëjë Kuvendi”.

Neni 13: “Fondi deri në 400 milionë lekë si lëndë “Fond rezervë” për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë pas miratimit paraprak të numrit nga Kuvendi”. Duke iu referuar ligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, pra neneve 10, 11 dhe 13 që unë jua

lexova këtu, roli i Kuvendit ka të bëjë me përcaktimin e numrit të përgjithshëm të strukturës të KLGJ-së dhe të KLP-së për vitin 2019, pasi duhet të preket fondi rezervë i parashikuar për ngritjen e organeve të reja të drejtësisë. Kuvendi në miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të dy këshillave merr në analizë nevojat për burime njerëzore, investime, shpenzime dhe të tjera që kërkohen prej tyre në raport me mundësinë buxhetore dhe financiare të zërave për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë.

Komisioni ynë në mbështetje të arsytimit të mësipërm mund të argumentojë dhe të propozojë numrin e stafit për secilin prej organeve të reja të qeverisjes së drejtësisë në rastin e KLGJ-së dhe të KLP-së, por e ka të pamundur të bëjë llogaritje për sa i takon mbështetjes buxhetore për shkak se llogaritja e nevojave për buxhet duhet të bëhet më pas, gjë që e thashë pak më lartë, pasi vetë organet të kenë të reflektuar në strukturë numrin dhe stafin që miraton Kuvendi i Shqipërisë.

Nga analiza dhe konsultimi i kryer me Ministrinë e Financave, me Drejtorinë e Administratës Publike, rezulton se mundësitë financiare për vitin 2019 për të dyja këto këshilla, edhe pas konsultimit që kemi bërë me dy drejtuesit disa ditë më parë, është 125 veta për KLGJ-në dhe 65 veta për KLP-në. Ne mendojmë se ky numër u përshtatet nevojave për fillimin e punës gjatë vitit në varësi të kërkesave të reja të dy këshillave për plotësimin me numër të punonjësve. Kuvendi mund ta rivlerësojë këtë çështje dhe i takon ta rivlerësojë edhe pasi të ngrihen strukturat e tjera, kjo edhe për faktin se po ky komision është komision përgjegjës edhe për përcaktimin e numrit të punonjësve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Byrosë Kombëtare të Hetimit, SPAK-ut dhe Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit që priten të fillojnë punën gjatë vitit 2019.

Pra, pas akordimit të nevojave për të gjitha institucionet numri i punonjësve për dy këshillat mund edhe të rishikohet në raport me nevojat që hasen gjatë ushtrimit të kompetencave, apo edhe të ekspozesë që bënë dy drejtuesit për ato që kanë kërkuar.

Në këto kushte komisioni i propozon Kuvendit t'i delegojë Këshillit të Ministrave analizën, shqyrtimin dhe miratimin e fondeve në përputhje me numrin e punonjësve të miratuar nga Kuvendi dhe strukturës së miratuar nga vetë organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Pra, mendoj që në përfundim të diskutimeve dhe pas konsultimit që kemi bërë me Ministrinë e Financave dhe me Komisionin e Departamentit të Administratës Publike, Komisioni i Ligjeve të votojë që numri i punonjësve për KLGJ-në të jetë 125 dhe numri i punonjësve për KLP-në të jetë 65, për vitin 2019. Duke i marrë të dyja këto së bashku do t'ju thosha se janë të

mjaftueshme, janë të restauruara të gjitha problematikat, sepse përveç mundësive financiare që janë këto dhe ne po e fillojmë me një numër të konsiderueshëm qoftë për KLGJ-në, qoftë për KLP-në, dua të vë në vëmendjen e publikut dhe të komisionit, sepse në vëmendjen e dy drejtuesve e kam vënë, pasi e kemi diskutuar më parë, që një strukturë përbëhet nga dy pjesë, pjesa kryesore dhe pjesa ndihmëse. Pjesa kryesore ka të bëjë me atë për të cilën është krijuar ky institucion, kurse pjesa ndihmëse ndihmon në mbarëvajtjen e punës së institucionit.

Të gjitha kërkesat që kanë bërë drejtuesit apo edhe këshillat që kanë miratuar për hir të vërtetës, për pjesën kryesore, pse është krijuar ky institucion qoftë KLGJ-ja apo KLP-ja, unë personalisht si relator nga të gjitha konsultimet që kam bërë me të gjitha këto institucione apo edhe me dy drejtuesit kam qenë shumë i saktë dhe nuk kam prekur asgjë.

Sa i takon pjesës kryesore të këtyre dy institucioneve, për të cilën janë krijuar dhe do të funksionojnë në të ardhmen, ne e kemi lënë pothuajse sipas propozimit që kanë bërë vetë këshillat përkatëse të tyre. Të vetmen gjë që ne kemi prekur, le të themi, kemi ulur rreth 10 veta nga KLP-ja dhe rreth 19 veta nga KLGJ-ja, janë pjesë e stafit ndihmës, nisur nga eksperiencia, këta për hir të së vërtetës nuk kanë eksperiencë në aspektin e strukturës ndihmëse jo të pjesës kryesore. Kur ngremë institucione të tilla, mendoj se rregullimi që kemi bërë në bazë të diskutimeve besoj se zgjidh edhe problemin ndihmës. Zakonisht, raportet janë 80 me 20, pra 80% është pjesa kryesore e institucionit dhe 20% është pjesa ndihmëse.

Me këto ndryshime të vogla dhe të pallogaritshme që ne kemi bërë, do të thosha unë, jam shumë i bindur që të dy këshillat do të mbeten shumë të kënaqur, mendoj se ne e realizojmë ngritjen e strukturave, të pjesës ndihmëse, për të cilat kemi krijuar.

Ashtu siç e thashë edhe në fjalën time, zoti kryetar, ne kemi komision përgjegjës, ne presim që të krijojmë edhe disa institucione të tjera kryesore, si: Byronë Kombëtare të Hetimit, SPAK-un ose Gjykatën e Posaçme Kundër Korrupsionit, dhe gjatë vitit 2019 do të kemi po prapë ne që do të miratojmë strukturat e këtyre institucioneve. Fondi rezervë që ka lënë qeveria për 250 veta, si numër, dhe 400 milionë lekë për vitin 2019, për rastin konkret 190 punonjës, pra 125 plus 65, të KLP-së bëhen 190, pra mbetet një kuadër rezervë për institucionet e tjera, mund të jenë shumë më pak, këta e kanë përfitimin, këtë për humor e them, sepse janë të parët që e miratojnë numrin e punonjësve dhe ne kemi korrektë në miratimin e tyre. Edhe ata që do të vijnë më pas mund të kërkojnë shumë gjëra të tjera dhe ne mund të mos kemi mundësi mbi bazën e atij numri

që ka mbetur ose të fondit të pagave, por gjithsesi unë mendoj se sot e zgjidhim përfundimisht miratimin e numrit të punonjësve për KLGJ- në dhe KLP-në.

Pasi ta miratojmë, nëse ka pyetje nga kolegët jam i gatshëm të përgjigjem, sepse kam punuar për një kohë të gjatë për këto dy struktura, ne do t'ju sugjeronim që pasi vendimi të dalë nga Kuvendi, vendim në të cilin do të shkruhet që KLGJ- ja do të ketë këtë numër dhe KLP-ja këtë numër pjesa tjetër do të jetë në funksion të Këshillit të Ministrave këta zotërinjtë duhet të bëjnë prapë mbledhje në këshillat përkatës për ta ristrukturuar strukturën mbi bazën e numrit që miratojmë ne si Kuvend dhe pas kësaj duhet të bëjnë një konsultim me DAP-in, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, për kategorizimin e pagave të punonjësve, të cilat janë element i Këshillit të Ministrave, pastaj mbi bazën e kësaj do të bëhet llogaritja sa do të jetë fondi i pagës për 125 veta të KLGJ-së dhe për 65 të KLP-së.

Ulsi Manja- A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka pyetje.

A ka diskutime? Nuk ka as diskutime.

Para se të hedh në votim të dy projektvendimet për KLP-në dhe KLGJ-në, dua t'iu bëj me dije kolegëve të mi të komisionit, që Komisioni i Ligjeve i është drejtuar edhe Ministrisë së Financave, DAP-it, misionit EURALIUS dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilat, siç e tha kolegu Fino, kanë një projeksion lidhur me 4 institucionet e reja të drejtësisë që krijohen, pra KLGJ –në, KLP-në, ILD-në dhe BKH-në, këto të fundit janë në pritje për t'u ngritur si institucione.

Në fakt, përgjigjet kanë ardhur, Ministria e Financave është shprehur dakord në parim lidhur me rishpërndarjen e fondit rezervë sipas ligjit të buxhetit për sistemin e drejtësisë të vitit 2019, por edhe DAP-i është shprehur parimisht dakord me strukturën e miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ajo që dua të sjell në vëmendje është sipas mendimit ose opinionit të sjellë nga misioni EURALIUS, në fakt, zoti Fino, për KLP-në projeksioni ka qenë 61 punonjës, dhe ajo që ju sugjeroni nga 75 që ka kërkuar vetë KLP-ja dhe ajo që propozoni prej 65 vetash është pak a shumë e njëjta, ndërsa lidhur me strukturën e KLGJ-së Ministria e Drejtësisë dhe misioni EURALIUS kanë një projeksion rreth 106 punonjës, ndërkohë që KLGJ-ja vetë ka kërkuar 144 punonjës, Komisioni i Ligjeve dhe ju, si relatorë, sugjeroni një numër prej 125 punonjësish për KLGJ-në.

Janë dy institucione të reja, që sapo kanë filluar punën e tyre dhe arsyeja që jemi sot në Komisionin e Ligjeve dhe që u shpjegua qartësisht nga zoti Fino, është ligji i buxhetit i vitit 2019, përkatësisht neni 11 dhe neni 13, sepse rishpërndarja e numrit të punonjësve të institucioneve të

sistemit të drejtësisë dhe i fondit rezervë bëhet nga Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak nga Kuvendi, pra ne këtu nuk miratojmë strukturën, as të KLGJ-së, as të KLP-së, sepse sipas nenit 79/2 dhe nenit 178/2 të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, janë vetë këto dy organe që miratojnë strukturat e tyre. Ne japim vetëm numrin e punonjësve dhe fondin rezervë që do të preket për këtë numër punonjësish.

Përpara se ta hedh në votim, më lejoni të lexoj projektvendimin për miratimin e numrit të punonjësve të KLGJ-së.

“Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 11 dhe 13 të ligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019”, i ndryshuar Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

1. Miratimin e numrit të punonjësve të KLGJ-së ,125
2. Fondi për krijimin dhe funksionimin e KLGJ-së të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

Bashkim Fino- Para votimit, zoti kryetar duhet të them diçka që unë e trajtova në relacion, por nuk doja të hyja në gjëra teknike, për të diskutuar për atë projeksion që thatë ju që KLP-ja, sipas EURALIUS-it duhej të kishte 61 punonjës dhe KLGJ-ja 106 punonjës. Unë i kam studiuar me kujdes të gjitha materialet që ka sjellë Ministria e Drejtësisë dhe EURALIUS –i, dhe më duhet të them që kanë qenë shumë të cunguar në kërkesën për numrin e punonjësve, por ajo nga e cila unë jam udhëhequr dhe që më kanë bindur edhe dy drejtuesit, të cilët i falënderoj, edhe këshilli duhet t’i falënderojë dy drejtuesit e KLGJ-së dhe KLP-së për argumentet shteruese që kanë sjellë, që kjo strukturë duhet të jetë me këto numra që ne të paktën të propozojmë, kemi lënë sipas ligjit që kemi miratuar. Çfarë kemi miratuar me ligj njësitë mbështetëse, që unë i citova më lart, ne i kemi lënë në strukturat e tyre dhe nuk ua kemi prekur, se e thotë ligji.

Ajo që dua të them për EURAULIS-in, mendoj se ne duhet të bëjmë ndonjëherë vërejtje edhe për të huajt, sepse realisht nuk duhet të pranojmë çdo lloj kërkesë që ata bëjnë.

Më lejoni t’ju them se EURALIUS-i ka bërë një analizë në kuptim të ligjit nr. 90 të vitit 2012, i cili rregullon organizimin dhe strukturën e administratës shtetërore që do të thotë, por nëse do të merrnim në konsideratë atë çfarë kanë thënë misioni EURALIUS dhe Ministria e Drejtësisë, nuk do të ishte ky numër që ne propozojmë për ta votuar sot në këtë komision të nderuar.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Kush e do fjalën nga përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor, para se ta hedhim në votim projektvendimin?

Po, zoti Qoku.

Maksim Qoku – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Ne kemi qenë shumë racionalë në vendosjen e atij numri, sepse në mënyrë që ne të ekzistonim si institucion na mjaftonin 106 punonjës, por që të jemi sa më efektivë numri duhet të jetë 145 punonjës, sepse ne synojmë që të jemi rezultativë. Ju e dini që shumica e përfaqësuesve këtu vijnë nga fakultetet, çka do të thotë se tani që janë në atë pozicion e shikojnë sistemin të dërrmuar, dhe jemi të ndarë në dy kolona: për emergjencat që na vijnë dhe për atë çka ne duhet të rregullojmë. Në mënyrë që ne të jemi sa më rezultativë, ne duhet të jemi 180.

Unë e dëgjova me vëmendje relacionin dhe e vlerësoj me të vërtetë, pasi është një relacion i përgatitur dhe i thelluar mirë. Gjithashtu, më erdhi edhe keq, pasi ne jemi një shtet i varfër dhe u duk sikur nuk menduam për organet që do të vijnë apo do të krijohen në të ardhmen, por menduam vetëm për organet tona. KLP-ja e ka Prokurorinë e Përgjithshme, e cila, me sistemin e ri të ligjeve dhe me kompetencat e ndara, mendoj se e ndihmojnë njëri-tjetrin 50 me 50. Gjithashtu, nëse do të shikojmë numrin e punonjësve të KLP-së dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, kam përshtypjen se i kalon 200. Ndërkohë, në bazë të ligjit, të paktën unë kam marrë sot me vete vetëm 115-ën, janë rreth 30 kompetenca që kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë, kemi përthithur ZABGJ-në, sepse sot buxhetet i ka KLGJ-ja, dhe shumë kompetenca të tjera, që të gjitha kërkojnë një infrastrukturë ndihmëse. Kështu, nëse do të kihet parasysh numri i punonjësve të KLP-së dhe i Prokurorisë së Përgjithshme kundrejt numrit që ne kemi nevojë, në mënyrë që të jemi sa më rezultativë, mund të them se na duhen 180.

Atëherë, shumë herë në mbledhje ne kemi vendosur që të jemi më racionalë dhe të zbresim minimalisht në numrin 144 për të qenë efektivë. Natyrisht, lidhur edhe me nevojat që do të kenë për atë fond rezervë organet të reja që priten të realizohen, unë përsëri mund të jem racional dhe të tërhiqem, por jo se kemi qenë të papjekur apo se kemi dashur të përfitojmë, por menduam se me këtë numër do të jemi më efektivë.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Qoku!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Në qoftë se zëvendëskryetari këtu kërkoi që të ishte korrekt me publikun, por edhe me komisionin, mirë bëri, por në qoftë se do të diskutonte më parë me mua personalisht dhe me të gjitha institucionet, që unë përmenda, dhe me përllogaritjet që kemi bërë, sot do të ishte shumë i lumtur me shifrat që unë thashë. Struktura e paraqitur nga ana e tyre, unë e thashë në fillim dhe po e rithem, ka ardhur për shkak të mungesës së përvojës për të bërë një strukturë të re. Strukturat përbëhen nga pjesa kryesore dhe pjesa ndihmëse. Nuk mund të lejoj unë që pjesa ndihmëse, që nuk ka lidhje fare me punën tuaj, të ketë 40% të numrit të punonjësve. Absolutisht, jo! Unë ta kam dhënë 31% dhe përsëri shumë ta kam lënë, sepse duhet të ishte 20%. Tani, edhe 31%, që ta kam lënë, ti përsëri po më thua që të shtoj punonjës të tjerë?! Mua kjo më duket absurde dhe jo korrekte në sensin e të gjithë asaj pune që ne e kemi bërë vërtet shumë të detajuar duke e shqyrtuar sipas ligjit. Çfarë keni kërkuar në pjesën kryesore të ligjit, ne nuk kemi prekur asgjë dhe asnjë punonjës nuk e kemi ulur nga pjesa e drejtorive kryesore për sa i përket pse është krijuar KLGJ-ja dhe KLP-ja. Lidhur me pjesën ndihmëse, që është pjesë në funksion në mënyrë që ju ta bëni sa më mirë punën, natyrisht ne nuk mund të vendosim më shumë se sa ka Kuvendi, ministritë apo edhe institucionet e tjera. Ju nuk duhet të harroni, nuk dua t’i futem fare këtij diskutimi, atë çfarë këta kanë përfutuar me status. Ata mund të kenë përfutuar disa gjëra me status, jashtë çdo rregulli, që mbase ne duhet t’i rishikojmë, por përsëri ne i kemi vlerësuar dhe u kemi thënë që ta marrin statusin. Në qoftë se këta kanë përfutuar statusin e kryetarit të Gjykatës së Lartë me ligjin që ne kemi bërë, nuk i kemi ngacmuar këtu në strukturë.

Unë shpreh të drejtën time, si deputet i kësaj maxhorance, të marr iniciativën dhe të kërkoj heqjen e statusit, siç e ka kryetari i Gjykatës së Lartë, sepse nuk e meritojnë që të kenë këtë status kaq të veçantë në një kohë që ne jemi republikë parlamentare. Pra, parlamenti është i pari dhe më pas vijnë të gjitha institucionet e tjera kushtetuese. Në qoftë se ne e rrëzojmë atë status, do të thotë që struktura e tyre do të rrëzohet edhe më shumë, do të bjerë jo në 106, siç thotë EURALIUS-i , por do të shkojë në 85.

Prandaj, meqenëse jam shumë i ditur në këto punë, mund të them se diskutimi i zëvendëskryetarit ishte i tepërt, madje shumë i tepërt. Për shkak të procedurës, zoti kryetar, ju nuk duhet t’i kishit dhënë fjalën, pasi unë mbarova fjalinë time si relator. Kur unë e mbarova fjalën time si relator, zoti kryetar, ju duhet ta hidhnit projektvendimin në votim dhe jo t’u jepnit fjalën këtyre.

Ata mund ta merrnin fjalën në fillim edhe tre apo pesë herë për të bërë sugjerimet, pyetjet dhe vërejtjet e tyre, por kur unë e mora fjalën në fund, si relator, apo kushdo nga kolegët e mi, që mund të ishte relator, dhe ju bëtë diskutimin e mbylljes, ky projektvendim duhej të hidhej në votim dhe nuk duhej të diskutohej më. Diskutimi i nënkryetarit më krijoi perceptimin se ndoshta duhet ta rishikojmë edhe një herë këtë strukturë.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

(Diskutime pa mikrofon.)

Në fakt, që të jem korrektë, zoti Fino, unë ua dhashë fjalën përfaqësuesve të KLGJ-së për të shprehur dakordësinë për miratimin e strukturës para se ta hidhja në votim projektvendimit. Këtë e bëra edhe për efekt të rekordeve, por jo që të shprehen për prezantimin e strukturës. Gjithsesi, vazhdojmë me votimin.

Kush është dakord me projektvendimin “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor” me 125 punonjës? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektvendimi për miratimin e numrit të punonjësve të KLGJ-së, sipas këtij përcaktimi:

“ 1. Miratimin e numrit të punonjësve të KLGJ-së me 125.

2. Fondi për krijimin dhe funksionimin e KLGJ-së të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi në seancë plenare.”

Hedhim në votim projektvendimin “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” me të njëjtin formulim.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 11 dhe 13 të ligjit “Për buxhetin e shtetit të viti 2019”, të ndryshuar”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

“ 1. Miratimin e numrit të numrit të punonjësve të KLP-së me 65.

2. Fondi për krijimin dhe funksionimin e KLP-së të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi në seancë plenare.”

Kush është dakord me projektvendimin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Të dyja projektvendimet, së bashku me relacionin përkatës, të përgatiten dhe t’i kalojnë seancës plenare për votim në seancën e datës 21 shkurt 2019.

Para se ta mbyll, dua të falënderoj kolegët e mi deputetë për seriozitetin me të cilën i trajtuan këto dy çështje të rendit të ditës!

Falënderoj relatorin, kolegun Fino, që ka punuar ngushtësisht me të dyja këshillat, qoftë me kryetarin e KLGJ-së dhe me kryetarin e KLP-së, përkatësisht zonjën Llagami dhe zotin Ibrahim, për të arritur në këtë dakordësi në numrin e punonjësve! Është e vërtetë që ne jemi në fazat e para të këtyre dy këshillave shumë të rëndësishëm.

Gjithashtu, dua të falënderoj edhe Këshillin e Ministrave, përkatësisht Ministrinë e Financave, Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë dhe misionin EURALIUS, sepse kjo që ne votuam sot tregon seriozitetin e kësaj maxhorance dhe të Kuvendit të Shqipërisë për t'i dhënë suportin e duhur reformës në drejtësi dhe të gjitha institucioneve të reja të drejtësisë që janë krijuar deri tani dhe që janë në rrugë e sipër për t'u krijuar, siç janë SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, të cilat do të krijohen shumë shpejt!

Unë e kam theksuar edhe herë të tjera, se askush nuk e pengon më ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë. Me mandate të djegura apo me mandate të plota një gjë është e qartë: Kuvendit të Shqipërisë i takon vetëm të japë suportin e duhur financiar për funksionimin e këtyre organeve, por nuk ka asgjë që e pengon reformën në drejtësi dhe ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë.

Mbledhjen e radhës së bashku me rendin e ditës do t'juaj njoftojmë nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA